

**RREGULLORJA PËR ASISTENCËN FINANCIARE**  
**NUVANCE HEALTH HOSPITALS**

**Në fuqi:**

**I. RREGULLORJA**

**A.** Historiku: Nuvance Health ("Nuvance") është një organizatë jofitimprurëse, e përjashtuar nga tatimi, e cila është e përkushtuar të sjellë avancime në shëndetin dhe mirëqenien e komuniteteve të saj duke ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe kosto-efektive. Në përputhje me këtë mision, Nuvance është përkushtuar që të ofrojë asistencë financiare për të mundësuar marrjen e trajtimit të nevojshëm mjekësor dhe kujdesit mjekësor emergjent nga spitalet e Nuvance, pavarësisht nga mundësia për të paguar. Kjo rregullore për asistencën financiare ("rregullorja" ose "FAP") zbatohet për kujdesin spitalor dhe ambulator të ofruar nga spitalet e mëposhtme Nuvance (secili prej tyre "spitali" dhe të gjithë së bashku "spitalet"):

- Danbury Hospital (duke përfshirë kampusin e tij New Milford Hospital)
- Norwalk Hospital
- Sharon Hospital
- Vassar Brothers Medical Center
- Putnam Hospital Center
- Northern Dutchess Hospital

Kjo rregullore zbatohet për spitalet dhe për punonjësit e tyre, por nuk zbatohet për të gjithë ofruesit që mund t'u ofrojnë shërbime pacientëve në spitale. Lista me ofruesit që ofrojnë shërbime emergjence dhe kujdesin e nevojshëm mjekësor në spitale, së bashku me informacionin se cilët prej këtyre ofruesve mbulojnë nga kjo rregullore, jepet bashkëlidhur rregullores si shtojca 1.

**B.** Shërbimet që mbulojnë: Përveç misionit të saj bamirës, Nuvance ofron asistencë financiare, duke përfshirë, por jo vetëm, kujdes shëndetësor falas ose me zbritje ("asistenca financiare") për pacientët e pranueshëm që marrin trajtim mjekësor emergjent dhe trajtime të tjera mjekësore të nevojshme (siç përcaktohet në përputhje me standardet e pranuarë përgjithësisht të mjekësisë në komunitet), në përputhje me këtë rregullore. Kjo rregullore nuk përfshin shërbimet që nuk janë të nevojshme nga ana mjekësore, si procedurat kozmetike me dëshirë, dhomat private ose infermieret private dhe shërbimet me dëshirë që ofrohen për lehtësi.

**C.** Qëllimi: Nuvance e rishikon rregullisht këtë rregullore për t'u siguruar që, gjatë gjithë kohës, ajo: (i) reflekton filozofinë dhe misionin e Nuvance; (ii) shpjegon procesin për marrjen e asistencës financiare; dhe (iii) u përmbahet të gjitha ligjeve dhe rregullave të zbatueshme shtetërore dhe federale në lidhje me ofrimin e asistencës financiare për pacientët e pranueshëm, duke përfshirë, por jo vetëm, seksionin 501(r) të Kodit për të Ardhurat e Brendshme të vitit 1986, i ndryshuar, dhe Rregullave të Thesarit të Nxjerra në

zbatim të tij. Në rast se ligjet ose rregullat e zbatueshme ndryshohen, u bëhen shtesa ose sqarime përmes drejtimit interpretues, Nuvance do ta modifikojë këtë rregullore dhe praktikat e saj, dhe do ta implementojë këtë rregullore në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme, si dhe në përputhje me drejtimin e spitaleve. Nëse ekziston një mospërputhje mes kësaj rregulloreje dhe ligjeve e rregullave të zbatueshme, kjo rregullore duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme.

**D.** Nuvance ka një rregullore të veçantë për kreditimin dhe mbledhjen e detyrimeve, një kopje të së cilës mund ta merrni duke kontaktuar **Shërbimet Financiare për Pacientin në (203) 730-5800**. Rregullorja për kreditimin dhe mbledhjen e detyrimeve përcakton veprimet dhe afatet kohore të këtyre veprimeve, që mund të merren në rast mospagese të shumave, të cilat konsiderohen përgjegjësi e pacientit sipas kësaj rregulloreje. Siç tregohet më poshtë, Nuvance nuk do të nisë veprime për mbledhjen e detyrimeve kundër një pacienti pa i dhënë më parë mundësinë pacientit të aplikojë për asistencë financiare (ose ndërkohë që ky aplikim është në pritje).

**E.** Pacientët, pjesëtarët e familjes ose personat e tjerë që kanë ndonjë pyetje në lidhje me këtë rregullore apo në lidhje me rregulloret e tjera të Nuvance për zbritjet dhe pagesat për kujdesin shëndetësor, mund të kontaktojnë Departamentin e Këshillimit Financiar të Nuvance në:

- Danbury Hospital: (203) 739-7773  
24 Hospital Avenue, Danbury, CT 06810  
5th floor Tower Lobby Business Unit (Orari, E hënë-E premte, 9 a.m. – 4 p.m.)
- Norwalk Hospital: (203) 852-1579  
34 Maple Street, Norwalk, CT 06856  
1st floor Trefz Lobby (Walk-In Mon-Fri, 9 a.m. – 4 p.m.)
- New Milford Hospital: (860) 210-5427  
21 Elm Street, New Milford, CT 06776
- Sharon Hospital: (860) 364-4275  
50 Hospital Hill Road, Sharon, CT 06069  
1st Floor (Walk-In Mon-Fri, 8 a.m. – 4:30 p.m.)
- Vassar Brothers Medical Center: (845) 431-5693  
45 Reade Place, Poughkeepsie, NY 12601  
2nd Floor Community Circle (Walk-In Mon-Fri, 8:30 a.m. – 5 p.m.)
- Putnam Hospital Center: (845) 279-5711, x4789  
670 Stoneleigh Avenue, Carmel Hamlet, NY 10512  
1st Floor Lobby (Orari, E hënë-E premte, 7:30 a.m. – 4 p.m.)
- Northern Dutchess Hospital: (845) 871-4347 6511 Spring Brook Avenue,  
Rhinebeck, NY 12572  
Main Lobby (Orari, E hënë-E premte, 8 a.m. – 4 p.m.)

Kjo rregullore, përmbledhja në gjuhë të thjeshtë e kësaj rregulloreje dhe rregullorja e Nuvance për kreditimin dhe mbledhjen e detyrimeve mund të gjenden gjithashtu online në:

[WWW.NUVANCEHEALTH.ORG/FINANCIALASSISTANCE](http://WWW.NUVANCEHEALTH.ORG/FINANCIALASSISTANCE)

## II. PRANUESHMËRIA DHE PËRCAKTIMI I ASISTENCËS FINANCIARE

**A. Pranueshmëria:** Një pacient mund të pranohet për asistencë financiare nëse pacienti: (i) ka sigurim shëndetësor të kufizuar ose nuk ka fare; (ii) nuk kualifikohet për programet qeveritare të asistencës mjekësore (për shembull, Medicaid); ose (iii) nuk është në gjendje të paguajë për kujdesin shëndetësor, duke u bazuar në rrethanat financiare individuale të pacientit (përfshirë edhe për shkak të vështirësive të mundshme mjekësore). Për të marrë ndihmë financiare, një pacient duhet të bashkëpunojë me Nuvance për të ofruar informacionin dhe dokumentacionin financiar të nevojshëm, të japë prova për “nevojën financiare” në bazë të kritereve të FAP, duke përfshirë **Dokumentin 1**, dhe t’i shfrytëzojë të gjitha mundësitë për pagesë nga palët e treta që janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme për pacientin. Në përcaktimin e rrethanave financiare individuale të një pacienti, Nuvance mund të marrë parasysh ekzistencën e borxheve të konsiderueshme mjekësore, kërkesat për zbritje të planit dhe, në përputhje me këtë rregullore, mund të kërkohet dokumentacion shtesë në lidhje me pasuritë dhe shpenzimet e jetesës (me kusht që Nuvance të mos e konsiderojë si pasuri vendbanimin kryesor të një pacienti, shumat që mbahen si shtyrje të tatimeve ose llogaritë e kursimeve për pension, llogaritë e kursimit për shkollim ose makinat që përdoren rregullisht nga pacienti ose pjesëtarët e afërt të familjes). Për të shmangur dyshimet, spitalet e Nuvance në Nju-Jork nuk do të analizojnë ose nuk do të marrin parasysh pasuritë e një personi (d.m.th., përveç formave aktuale të të ardhurave që tregohen te pika II(B) më poshtë) në marrjen e një vendimi në lidhje me disponueshmërinë e asistencës financiare në rastet ku është e ndaluar nga ligjet e shtetit, dhe spitalet e Nuvance në Konektikat do të analizojnë ose do të marrin parasysh pasuritë e një individi, vetëm nëse kjo do t’i jepte mundësi individit të pranohej, ose do të rriste shumën e asistencës financiare sipas kësaj rregulloreje. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, fjala "pacient" përdoret në lidhje me pacientin ose me burimin e pagesës për kujdesin shëndetësor të pacientit (*p.sh.*, prind, kujdestar, bashkëshort ose palë tjetër përgjegjëse), dhe referencat për "të ardhurat" u referohen të ardhurave familjare, përveçse kur deklarohet ndryshe.

**B. Nevoja financiare:** Një pacient do të konsiderohet se është në nevojë financiare duke u bazuar në direktivat federale për varfërinë (“FPG”) të nxjerra nga Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore. Në tabelën e mëposhtme tregohen kërkesat për të ardhurat dhe zbritjen përkatëse në lidhje me pagesat për shërbimet e ofruara nga Nuvance. Të ardhurat përfshijnë rrogat dhe pagat, komisionet e marra, dëmshpërblimet ose pagesat e tjera të marra nga vendimet gjyqësore, kompensimi për papunësi, kompensimi për punëtorin, dividendët, çeqet me interes dhe burimet e tjera të përsëritshme të të ardhurave, siç dokumentohen nga pacientët në përputhje me këtë rregullore.

<b>TË ARDHURAT FAMILJARE TË PACIENTIT</b>	<b>ZBRITJA</b>
Në ose nën 300% të FPG	100% ose kujdes shëndetësor falas
Mbi 300% deri në 350% të FPG	75% zbritje
Mbi 350% deri në 400% të FPG	Zbritje AGB Shumat e faturuara përgjithësisht  <b>(% ndryshon çdo vit për çdo spital, shiko dokumentin 1 për hollësi)</b>

**C. Llogaritja e shumave për faturim:** Në asnjë rast një pacient që kualifikohet për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje, nuk do të tarifohet për kujdesin e nevojshëm emergjent dhe mjekësor më shumë sesa shumat që çdo spital u faturon përgjithësisht ("AGB") personave që kanë sigurim që e mbulon këtë kujdes të nevojshëm emergjent ose mjekësor dhe, për sa u përket të gjitha kujdeseve të tjera shëndetësore, me një shumë të barabartë ose më të madhe se tarifat bruto për këtë kujdes shëndetësor. Nuvance e llogarit AGB duke përdorur "metodën retrospektive" të bazuar në normat e tregut dhe të Medicare për tarifatat e shërbimit. Shuma neto që i tarifohet një pacienti që kualifikohet këtu për asistencë financiare, do të përcaktohet (i) duke llogaritur detyrimet bruto për shërbimet që i janë ofruar pacientit, dhe (ii) duke aplikuar zbritjen e përshtatshme (siç përcaktohet më sipër dhe sipas dokumentit 1).

Megjithatë, pavarësisht nga sa më sipër, Nuvance mund t'i shtojë zbritjet ose mund të vendosë çmime specifike për pacientët e pranueshëm nga FAP, të cilët përmbushin kritere specifike në Konektikat ose në Nju-Jork, në bazë të ligjeve dhe rregullave të zbatueshme në ato shtete, duke përfshirë si më poshtë:

### **Nju-Jork**

Pacientët me të ardhura në ose nën 100% të FPG kualifikohen të marrin shërbime shëndetësore emergjente dhe shërbime të nevojshme mjekësore falas ose në nivelin nominal të pagesës për shërbimet specifike të përcaktuara nga Departamenti i Shëndetësisë i Nju-Jorkut.

### **Konektikat**

Në përputhje me Conn. Gen. Stat. § 19a-673, një spital në Konektikat nuk do ta tarifojë një pacient spitali të pasiguar (sipas përcaktimit sipas atij ligji), të ardhurat e të cilit (vetëm, pa marrë parasysh pasuritë e disponueshme) janë në ose nën 250% të FPG më shumë se kostoja e spitalit për ofrimin e shërbimeve për pacientin (të llogaritura si tarifatat e publikuara të spitalit në kohën e faturimit,

të shumëzuara me raportin kosto-pagesë të spitalit të raportuar në Zyrën e Strategjisë së Shëndetësisë, në depozitim të raportit më të fundit financiar vjetor të disponueshëm të spitalit).

**D.** Pranueshmëria e supozuar: Pacientët e spitalit me të ardhura në ose nën 300% të FPG në mënyrë të supozuar konsiderohen si të pranueshëm për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje. Në rastet ku rrethanat e një pacienti tregojnë se pacienti mund të kualifikohet sipas kësaj rregulloreje për asistencë financiare, por spitali nuk ka qasje në dokumentacionin financiar të mjaftueshëm ose në informacionin në lidhje me pacientin për të marrë një vendim për pranueshmërinë e FAP, Nuvance mund të mbështetet te një vendim i mëparshëm për përcaktimin e pranueshmërisë për asistencë financiare, te burimet e palëve të treta ose te informacionet e vetë-raportuara në lidhje me rrethanat e jetës së një pacienti për të marrë një vendim për pranueshmërinë e supozuar për asistencë financiare, duke përfshirë, por jo vetëm, rastet kur një pacient është i pastrehë, është subjekt i një falimentimi të miratuar nga gjykata, ose ka vdekur pa pasur bashkëshort/e ose pasuri. Këto burime të palëve të treta mund të përfshijnë, por jo vetëm, programet softuerike të industrisë së kujdesit shëndetësor që përmbajnë të dhënat e regjistrimit publik për të llogaritur një rezultat për kapacitetin socio-ekonomik dhe financiar, i cili nga ana tjetër mund të përdoret për të gjykuar pranueshmërinë për asistencë financiare.

**E.** Mosdiskriminimi: Nuvance nuk do të marrë parasysh racën, gjininë, moshën, orientimin seksual, përkatësinë fetare, aftësitë e kufizuara, kombësinë, statusin social ose të emigracionit, gjendjen mjekësore (përveç kufizimeve të zakonshme ose përjashtimeve të bazuara në nevojën mjekësore apo dobinë klinike/terapeutike të një procedure ose trajtimi), ose statusin si veteran kur ofron kujdes shëndetësor ose kur merr vendime për pranueshmërinë sipas kësaj rregulloreje.

### **III. PROCEDURAT DHE DETYRIMET PËR MARRJEN E ASISTENCËS FINANCIARE**

**A.** Shënim për pacientët: Të gjithë pacientët do të informohen për disponueshmërinë e asistencës financiare sipas kësaj rregulloreje.

**B.** Asistenca për pacientin: Departamenti i Nuvance për Këshillimin Financiar do t'i ndihmojë pacientët të regjistrohen në programet federale dhe shtetërore të asistencës qeveritare, duke përfshirë, por jo vetëm, Programet për Shkëmbimin e Kujdesit Shëndetësor. Konsulentët financiarë të trajnuar dhe persona të tjerë të stafit mund të kontaktohen për ndihmë në plotësimin e aplikimit për ndihmë financiare ose me çfarëdo materiali tjetër që kërkohet nga Nuvance sipas kësaj rregulloreje:

- Danbury Hospital: (203) 739-7773
- Norwalk Hospital: (203) 852-1579
- New Milford Hospital: (860) 210-5427
- Sharon Hospital: (860) 364-4275
- Vassar Brothers Medical Center: (845) 431-5693
- Putnam Hospital Center: (845) 279-5711, x4789
- Northern Dutchess Hospital: (845) 871-4347

C. Afati kohor për marrjen e vendimeve: Nuvance do të përpiqet të marrë vendimin për pranueshmërinë FAP gjatë regjistrimit paraprak ose para daljes nga spitali. Megjithatë, **një pacient mund të kërkojë kompensim në çdo kohë pas daljes ose pas datës së ofrimit të shërbimit, dhe Nuvance do të shqyrtojë pranueshmërinë e pacientit sipas kësaj rregulloreje siç kërkohet, deri në, dhe duke përshirë pagesën gjatë fazës së mbledhjes së detyrimeve dhe gjykimit.** Pacientët nxiten të kontaktojnë Departamentin e Nuvance për Këshillimin Financiar nëse rrethanat e tyre ndryshojnë ose nëse identifikohen nevoja të mëtejshme. Konsulentët financiarë të Nuvance do t'i shqyrtojnë të gjitha informacionet e ofruara dhe rrethanat përkatëse, duke mbajtur parasysh nevojën për asistencë financiare, do të marrin një vendim për pranueshmërinë dhe do të njoftojnë pacientin për detyrimet e tij financiare, nëse ka, siç përcaktohet më poshtë.

D. Procedurat administrative:

1. Stafi i spitalit do t'u përcjellë menjëherë konsulentëve financiarë të Nuvance një kopje të kartelës së shtrimit paraprak për çdo pacient që nuk ka sigurim. Konsulentët financiarë do të kontaktojnë pacientin për të programuar një intervistë financiare sa më parë që të jetë e mundur, por idealisht para shtrimit për një shërbim jo-emergjent, të nevojshëm nga ana mjekësore, dhe para daljes ose largimit për një shtrim emergjent ose shërbim ambulator. Për shërbimet e urgjencës, Nuvance nuk do ta vonojë ekzaminimin ose trajtimin e një gjendjeje mjekësore emergjente për të kryer këtë intervistë financiare ose për ndonjë arsye tjetër sipas kësaj rregulloreje. Secili spital do t'u përmbahet plotësisht detyrimeve që ka sipas Ligjit për Trajtimin Mjekësor Emergjent dhe Punën Aktive ("EMTALA") gjatë trajtimit të pacientëve që paraqiten me probleme mjekësore emergjente (siç përcaktohet në EMTALA). Për të përcaktuar nëse një pacient kualifikohet ose jo për asistencë financiare, pacientit do t'i kërkohet të plotësojë dokumentin financiar për pacientin (shiko **Shtojcat 2-CT** dhe **2-NY**). Dokumenti do t'u vihet në dispozicion pacientëve me anë të metodave të mëposhtme, ku përfshihen (por jo vetëm) postimi në faqen e internetit të spitalit, shpërndarja në ambientet e spitalit për regjistrimin dhe shtrimin e pacientëve dhe në zyrat e këshillimit financiar të pacientëve, si dhe përfshirja në afishet informative që gjenden te dhomat e pacientëve.

2. Pacientët duhet t'ia kthejnë dokumentin e plotësuar konsulentit financiar në zarfën e vetëadresuar me pullë të dhënë nga spitali, brenda njëzet (20) ditësh pas marrjes së dokumentit. Nëse një pacient nuk e paraqet informacionin në kohë, Nuvance do ta konsiderojë joaktiv aplikimin e pacientit dhe nuk do të japë asistencë financiare, përveç nëse pacienti konsiderohet i pranueshëm në ndonjë mënyrë tjetër (me kusht që një pacient të ketë mundësinë ta rihapë një aplikim joaktiv, të riaplikojë për asistencë financiare, të apelojë një refuzim nga Nuvance, dhe që pacientët të mund të japin informacion shtesë për ta mbështetur kërkesën për asistencë financiare në çfarëdo kohe). Pacientët janë të detyruar të bashkëpunojnë dhe të japin të gjithë informacionin e nevojshëm në kohë. Nuvance do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të ofruar dhe për t'u dhënë ndihmë pacientëve në lidhje me plotësimin e dokumentit. Megjithatë, nëse nevojitet ndihmë për mbledhjen e informacionit ose të materialeve të nevojshme që kërkohen si pjesë e procesit të kualifikimit për asistencë financiare, konsulentët financiarë janë në dispozicion për t'i

ndihmuar pacientët me vlerësimin e situatave të tyre financiare, me mbledhjen e informacionit që kërkohet nga Nuvance dhe me dhënien e ndihmës për punë të ngjashme:

- Danbury Hospital: (203) 739-7773
- Norwalk Hospital: (203) 852-1579
- New Milford Hospital: (860) 210-5427
- Sharon Hospital: (860) 364-4275
- Vassar Brothers Medical Center: (845) 431-5693
- Putnam Hospital Center: (845) 279-5711, x4789
- Northern Dutchess Hospital: (845) 871-4347

3. Si pjesë e procesit të intervistës financiare, konsulentët financiarë do të kërkojnë dokumentacionin e mëposhtëm për të përpunuar dhe miratuar aplikimet për asistencë financiare:

<b>Dokumentacioni mbështetës që kërkohet</b>	<b>Shembuj të dokumentacionit të pranueshëm</b>
Konfirmimi i të ardhurave vjetore	Deklarata tatimore më e fundit mbi të ardhurat federale (opsional, dhe nuk mund të kërkohet për një pacient të Nju-Jorkut) 4 çeqet e fundit të pagesës javore ose 2 çeqet e fundit të pagesës dyjavore Formulari më i fundit W-2 ose 1099-MISC Letra e ofrimit të Sigurimeve Shoqërore Deklarata e papunësisë Letra e ofrimit të kompensimit për punëtorin Letra ose deklarata e përfitimeve V.A.
Verifikimi i numrit të sigurimeve shoqërore dhe/ose data e lindjes	Leja e drejtimit Mjeti i identifikimit i lëshuar nga shteti Pasaportë Karta e sigurimeve shoqërore Certifikatë lindjeje Certifikatë pagëzimi Letrat e daljes nga ushtria Karta e lejes së qëndrimit të përhershëm për të huajt (Green Card) Listat e notave të shkollës, të certifikuara

Verifikimi i vendbanimit	Deklarata e kredisë për shtëpinë Kontrata e qirasë Fatura tatimore Deklarata për dhomën dhe ushqimin Faturë e shërbimeve utilitare Verifikim me shkrim nga pronari
--------------------------	---

- E.** Dokumentacioni mbështetës i renditur më sipër kërkohet nga të gjithë pacientët që kërkojnë asistencë financiare. Megjithatë, Nuvance, në gjykimin e tij, mund të heqë dorë nga kërkesa për të dorëzuar një pjesë ose të gjitha dokumentacionet në varësi të rrethanave dhe aftësisë së pacientit për të marrë dokumentacionin. Nuvance mund të mbështetet te dokumentacioni i marrë nga organizatat e kreditit ose nga ente të tjera të jashtme, duke përfshirë edhe partnerët e komunitetit të tij, në përcaktimin e pranueshmërisë për asistencë financiare.
- F.** Pacientët kanë detyrimin të dorëzojnë në kohë informacionin që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Nuvance për të marrë një vendim lidhur me pranueshmërinë e pacientit për asistencë financiare. **Nëse një pacient pretendon se pacienti nuk ka mundësi të paguajë, por nuk jep informacionin që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Nuvance, dhe pacienti nuk i plotëson ndryshe kriteret për vendimin për pranueshmërinë, nuk do të jepet asistencë financiare, dhe sipas gjykimit të vetëm të Nuvance mund të vazhdohet me përpjekjet normale për mbledhjen e detyrimeve, në përputhje me rregulloren për kreditimin dhe mbledhjen e detyrimeve.**
- G.** Pranueshmëria dhe procesi i njoftimit:
1. Pas marrjes së dokumentit të pasqyrës financiare të pacientit, Departamenti i Këshillimit Financiar do ta shqyrtojë aplikimin e pacientit për të përcaktuar nëse është i plotë, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Nëse nuk është i plotë, aplikimi do t'i kthehet pacientit për t'u plotësuar. Nëse Nuvance kthen te një pacient një aplikim që nuk është i plotë, konsulenti financiar do të përpiqet ta kontaktojë pacientin me telefon. Nëse konsulenti arrin ta kontaktojë pacientin me telefon, ai do t'i ofrojë pacientit një intervistë ballë për ballë ose me telefon për të përcaktuar pranueshmërinë e këtij pacienti për asistencë financiare. Nëse Nuvance nuk arrin ta kontaktojë pacientin me telefon, ose nëse nuk ka numër telefoni në dispozicion, konsulenti financiar do t'i dërgojë pacientit një letër ku tregohet në mënyrë të detajuar se çfarë nevojitet dhe ku pacientit i shpjegohet se është përgjegjësia e tij të kontaktojë Departamentin e Këshillimit Financiar ose ndryshe të dorëzojë informacionin që mungon brenda tridhjetë (30) ditësh pune pas marrjes së letrës. Konsulentët financiarë të trajnuar të Nuvance do të ofrojnë që të takohen me pacientin për ta ndihmuar pacientin të plotësojë një aplikim në mënyrë që Nuvance të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë një vendim për pranueshmërinë e pacientit për asistencë financiare.



2. Departamenti i Këshillimit Financiar do ta plotësojë formularin e përcaktimit të pranueshmërisë për asistencë financiare, të bashkëngjitur si **Shtojca 3**, dhe do të përcaktojë shumat që pacienti detyrohet të paguajë, nëse ka.  
Departamenti i Këshillimit Financiar do ta informojë pacientin për pranueshmërinë e tij për asistencë financiare dhe për shumën e kësaj asistence financiare, brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së vendimit.
  3. Çdo pacient që jep të gjitha informacionet e kërkuara dhe që refuzohet sipas kësaj rregulloreje, gëzon të drejtën ta apelojë këtë vendim me shkrim te Departamenti i Këshillimit Financiar. Letra e refuzimit duhet të përfshijë informacion ku tregohet me hollësi procesi i apelimit që është në dispozicion për pacientin. Çdo apelim duhet t'i caktohet supervisorit të Departamentit të Këshillimit Financiar për rishqyrtim. Një vendim me shkrim për apelimin do t'i dërgohet pacientit brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së kërkesës me shkrim të pacientit për apelim.
  4. Vendimi i pranueshmërisë sipas kësaj rregulloreje është i vlefshëm për një (1) vit. Pas kësaj periudhe, pacientët që vazhdojnë të kërkojnë shërbime të nevojshme mjekësore ose ata që paraqiten për trajtim mjekësor emergjent, parashikohet që të aplikojnë përsëri ose që të përditësojnë aplikimet e tyre të mëparshme sipas kësaj rregulloreje, me qëllim që t'i japin mundësi Nuvance të marrë një vendim të ri lidhur me vazhdimin e pranueshmërisë së pacientit për asistencë financiare; megjithatë, me kusht që, në përputhje me EMTALA, asnjë spital të mos vonojë, të mos refuzojë ose të mos kufizojë asnjë trajtim të një problemi mjekësor emergjent, për të përcaktuar pranueshmërinë për FAP.
- H.** Nuvance nuk do ta referojë një pacient te mbledhja e detyrimeve apo në të kundërt nuk do të nisë veprime për mbledhjen e detyrimeve kundër një pacienti pa i dhënë më parë mundësinë pacientit të aplikojë për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje, ose ndërkohë që aplikimi i një pacienti për asistencë financiare është në pritje ose duke u shqyrtuar nga Nuvance.
- I.** Mundësi të mëtejshme për asistencë financiare në komunitet

Përveç proceseve të asistencës financiare që tregohen më sipër, Nuvance mund ta zgjerojë asistencën financiare në formën e zbritjeve ose kujdesit shëndetësor falas për pacientët në rrethana të caktuara, siç bihet dakord me organizatat e komunitetit për të siguruar qasje të vazhdueshme në kujdesin shëndetësor për anëtarët vulnerabël të komunitetit. Për shembull, por jo vetëm, Nuvance ka lidhur disa marrëveshje të caktuara financiare për pacientët e referuar nga Americanes për shërbimet ambulatorë në spital, si edhe me Norwalk Community Health Center (për pacientët e së cilës Nuvance do të respektojë normën e lëvizshme të tarifave të qendrës shëndetësore, në rrethana të caktuara). Departamenti i Këshillimit Financiar i Nuvance do të japë informacion shtesë, pas kërkesës, në lidhje me zbritjet e mundshme ose në lidhje me faktin nëse zbatohet një marrëveshje me një organizatë komuniteti.

#### IV. KOMUNIKIMI

**A.** Disponueshmëria e asistencës: Nuvance do t' u komunikojë disponueshmërinë e asistencës financiare pacientëve të saj dhe publikut të gjerë në mënyra të tilla si, ofrimi dhe postimi i kopjeve të kësaj rregulloreje, përmbledhja në gjuhë të thjeshtë e kësaj rregulloreje, aplikimi për asistencë financiare, tabelat e përshtatshme dhe broshurat në faqen e internetit të Nuvance dhe në ambientet e saj; në secilin prej departamenteve të emergjencës së spitalit; në zonat e regjistrimit dhe shtrimit të pacientëve; në departamentet e këshillimit financiar të pacientëve; në zona të tjera pritjeje në ambientet e spitalit (siç mund të jetë e arritshme dhe e përshtatshme); në afishet informative të pacientëve në dhomat e pacientëve; në letrat e daljes nga spitali; dhe në faturat dhe dokumentet që u dërgohen pacientëve. Nuvance do t' i komunikojë më tej publikut se si të marrë kopje të kësaj rregulloreje, një përmbledhje në gjuhë të thjeshtë dhe aplikimin për asistencë financiare me postë dhe falas. Përveç kësaj, kjo rregullore, përmbledhja në gjuhë të thjeshtë e kësaj rregulloreje dhe rregullorja e Nuvance për kreditimin dhe mbledhjen e detyrimeve mund të gjenden gjithashtu online në:

[WWW.NUVANCEHEALTH.ORG/FINANCIALASSISTANCE](http://WWW.NUVANCEHEALTH.ORG/FINANCIALASSISTANCE)

**B.** Të disponueshme gjerësisht: Rregullorja dhe dokumentet përkatëse (duke përfshirë dokumentin e aplikimit dhe një përmbledhje në gjuhë të thjeshtë) do t' u vihen në dispozicion pacientëve dhe familjeve të tyre në anglisht, spanjisht, portugalisht dhe në çdo gjuhë tjetër të huaj që flitet nga të paktën 5% e komunitetit të cilit spitali i shërben, ose që flitet nga personat që nuk flasin anglisht, të cilët përbëjnë të paktën një për qind të një popullate të zonës së shërbimit kryesor të spitalit ose që arrin të paktën 1000 në numër. Gjuhë të tjera do të shtohen sipas nevojës në rast se ndodhin ndryshime në popullatën e pacientëve të një spitali. Të gjitha këto materiale do të përfshijnë numrat e telefonit të kontaktit dhe/ose adresat e emailit për t' u dhënë mundësi pacientëve të kenë qasje në burime të përshtatshme për plotësimin e dokumentit dhe për të marrë përgjigje për çdo pyetje që mund të kenë në lidhje me rregulloren e Nuvance për asistencën financiare.

#### V. DOKUMENTACIONI DHE REGJISTRIMET

**A.** Regjistrimet: Departamenti i Këshillimit Financiar do të mbajë të gjitha dokumentacionet e asistencës financiare brenda dosjes së asistencës financiare të spitalit. Dosja e asistencës financiare do të përfshijë një total të përgjithshëm të rasteve të asistencës financiare, së bashku me dokumentacionin mbështetës. Dokumentacioni mbështetës do të përfshijë, të paktën, të mëposhtmet: (i) Numrin e aplikuesve për shërbime falas dhe me kosto të reduktuar; (ii) numrin e aplikuesve të miratuar; (iii) tarifimet totale dhe mesatare dhe kostot e shumave të kujdesit shëndetësor të ofruar falas dhe me kosto të reduktuar; (iv) çdo informacion tjetër që kërkohet nga, ose që është i nevojshëm për të plotësuar dhe për të raportuar saktë sipas, ligjeve federale dhe ligjeve shtetërore (duke përfshirë, por jo vetëm, Conn. Gen. Stat. § 19a-673c, N.Y. Public Health Law § 2807-k(9), dhe I.R.C. §501(r)).

**B.** Shqyrtimi vjetor: Drejtori i Përgjithshëm i Financës do të shqyrtojë rregullisht statusin e programit të asistencës financiare me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv ose me të caktuarin e tij. Drejtori i Përgjithshëm i Financës ose i caktuari prej tij do të jetë përgjegjës për ta paraqitur këtë rregullore të asistencës financiare para bordit të drejtorëve të paktën një herë në vit. Ky prezantim do të përfshijë një deklaratë të detajuar për rregulloren e Nuvance për asistencën financiare, ndikimin e rregullores në aktivitetet e Nuvance dhe nivelin e nevojës dhe përfitimeve që i jepen komunitetit sipas programit të asistencës financiare.

**C.** Raportimi: Informacioni rreth shumës së asistencës financiare që u ofrohet pacientëve të Nuvance do të jepet në përputhje me ligjet dhe rregullat federale.

## SHTOJCA 1

### **UDHËZUESI I PRANUESHMËRISË PËR ASISTENCË FINANCIARE Bazuar në Udhëzuesin federal për varfërinë të vitit 2021\***

Madhësia e familjes**	Udhëzuesi federal për varfërinë (2021)	Në ose nën 300% të Udhëzuesit federal për varfërinë (100% zbritje)	>300% - 350% Udhëzuesi për varfërinë (75% zbritje)	>350% deri në 400% Udhëzuesi për varfërinë (Zbritja AGB)***
1	\$12,880	\$0 deri në \$38,640	\$38,641 deri në \$45,080	\$45,081 deri në \$51,520
2	\$17,420	\$0 deri në \$52,260	\$52,261 deri në \$60,970	\$60,971 deri në \$69,680
3	\$21,960	\$0 deri në \$65,880	\$65,881 deri në \$76,860	\$76,861 deri në \$87,840
4	\$26,500	\$0 deri në \$79,500	\$79,501 deri në \$92,750	\$92,751 deri në \$106,000
5	\$31,040	\$0 deri në \$93,120	\$93,121 deri në \$108,640	\$108,641 deri në \$124,160
6	\$35,580	\$0 deri në \$106,740	\$106,741 deri në \$124,530	\$124,531 deri në \$142,320
7	\$40,120	\$0 deri në \$120,360	\$120,361 deri në \$140,420	\$140,421 deri në \$160,480
8	\$44,660	\$0 deri në \$133,980	\$133,981 deri në \$156,310	\$156,311 deri në \$178,640

\* Kjo shtojcë përditësohet herë pas here për të reflektuar FPG-të më të fundit të nxjerra nga Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore.

\*\* Për njësitë familjare me më shumë se 8 pjesëtarë, për të përcaktuar shifrën bazë të udhëzuesit federal për varfërinë, shtohen \$4,540.00 për çdo pjesëtar shtesë.

\*\*\* Zbritja AGB ndryshon sipas spitalit:

- Danbury Hospital: 59,89%
- Norwalk Hospital: 61,86%
- New Milford Hospital: 59,89%
- Sharon Hospital: 55,53%
- Vassar Brothers Medical Center: 56,70%
- Putnam Hospital Center: 58,83%
- Northern Dutchess Hospital: 53,34%

**SHTOJCA 2-CT (Spitalet e Konektikatit)**  
**DOKUMENTI FINANCIAR I PACIENTIT/BURIMIT TË PAGESËS**

Emri i pacientit: \_\_\_\_\_

Numri i llogarisë: \_\_\_\_\_

Madhësia e familjes: \_\_\_\_\_

**1A Llogaritja e të ardhurave të disponueshme**

Paga mujore/Pensioni

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_

SSI/VA mujore

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_

**Totali i të ardhurave**

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_ (AA)

**1B Llogaritja e shpenzimeve mujore**

Qiraja

\_\_\_\_\_

Energjia elektrike

\_\_\_\_\_

Gazi

\_\_\_\_\_

Telefoni

\_\_\_\_\_

Uji

\_\_\_\_\_

Pagesat për makinën

\_\_\_\_\_

Kartat e kreditit

\_\_\_\_\_

Sigurimi

\_\_\_\_\_

Tjetër \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Ushqim (\$100.00 x personat në varësi)

\_\_\_\_\_

**Totali i shpenzimeve mujore**

\_\_\_\_\_

**Totali i shpenzimeve**

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_ (BB)

**1C Të ardhurat e pranueshme për faturat e spitalit  
(AA – BB) (Nëse është më pak se 0, shkruaj 1)**

\_\_\_\_\_ (CC)

**1D Përllogaritja e faturimit të spitalit për pacientin**

\_\_\_\_\_ (DD)

**1E Identifikimi i aseteve likuide**

Llogaritë bankare

\_\_\_\_\_

Bono thesari

\_\_\_\_\_

Aksione

\_\_\_\_\_

CD-të

\_\_\_\_\_

Fondet e përbashkëta

\_\_\_\_\_

**Totali i aseteve likuide**

\_\_\_\_\_ (EE)

**1F Totali i pacientit për pagesë minus asetet likuide (DD- EE)**

\_\_\_\_\_ (FF)

**1G Të ardhurat e pranueshme minus detyrimi i pacientit  
(CC-FF)**

\_\_\_\_\_ (GG)

Shënim: Nëse GG është numër negativ, atëherë pacienti nuk do të ketë përgjegjësi financiare.

\_\_\_\_\_ Pranoj se informacioni i mësipërm është i saktë.

\_\_\_\_\_ Pranoj se pacienti/burimi i pagesës është i papunë, ndaj nuk mund të jap dokumentacion për punësimin.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i pacientit/burimit të të ardhurave

\_\_\_\_\_  
Data

**SHTOJCA 2-NY (Spitalet e Nju-Jorkut)**  
**DOKUMENTI FINANCIAR I PACIENTIT/BURIMIT TË PAGESËS**

Emri i pacientit: \_\_\_\_\_  
Madhësia e familjes: \_\_\_\_\_

Numri i llogarisë: \_\_\_\_\_

**1A Llogaritja e të ardhurave të disponueshme**

Paga mujore/Pensioni

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_

SSI/VA mujore

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_

**Totali i të ardhurave**

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_ (AA)

**1B Llogaritja e shpenzimeve mujore**

Qiraja

\_\_\_\_\_

Energjia elektrike

\_\_\_\_\_

Gazi

\_\_\_\_\_

Telefoni

\_\_\_\_\_

Uji

\_\_\_\_\_

Pagesat për makinën

\_\_\_\_\_

Kartat e kreditit

\_\_\_\_\_

Sigurimi

\_\_\_\_\_

Tjetër \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Ushqim (\$100.00 x personat në varësi)

\_\_\_\_\_

**Totali i shpenzimeve mujore**

\_\_\_\_\_

**Totali i shpenzimeve**

\_\_\_\_\_ x 12 \_\_\_\_\_ (BB)

**1C Të ardhurat e pranueshme për faturat e spitalit** \_\_\_\_\_ (CC)  
**(AA – BB) (Nëse është më pak se 0, shkruaj 1)**

**1D Përlllogaritja e faturimit të spitalit për pacientin** \_\_\_\_\_ (DD)

**1E Të ardhurat e pranueshme minus detyrimi i pacientit (CC-DD)** \_\_\_\_\_ (EE)

**Shënim: Nëse EE është numër negativ, atëherë pacienti nuk do të ketë përgjegjësi financiare.**

\_\_\_\_\_ Pranoj se informacioni i mësipërm është i saktë.

\_\_\_\_\_ Pranoj se pacienti/burimi i pagesës është i papunë, ndaj nuk mund të jap dokumentacion për punësimin.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i pacientit/burimit të të ardhurave

\_\_\_\_\_  
Data

### SHTOJCA 3

## FORMULARI I PËRCAKTIMIT TË PRANUESHMËRISË PËR ASISTENCË FINANCIARE

Data: \_\_\_\_\_

Nuvance ka bërë një përcaktim të pranueshmërisë për Asistencë Financiare për:

Emri: \_\_\_\_\_

Numri i kartelës mjekësore: \_\_\_\_\_

Duke u bazuar në informacionin e dhënë nga pacienti ose në emër të pacientit, është marrë vendimi i mëposhtëm.

\_\_\_\_\_ Kërkesa juaj për asistencë financiare është refuzuar sepse të ardhurat tuaja e tejkalojnë pragun e përcaktuar në rregulloren e Nuvance për asistencën financiare.

\_\_\_\_\_ Kërkesa juaj për asistencë financiare është aprovuar për shërbimet e ofruara në \_\_\_\_\_ . E gjithë balanca do të trajtohet si kujdes shëndetësor falas.

\_\_\_\_\_ Kërkesa juaj për asistencë financiare është aprovuar në përputhje me shërbimet e ofruara në \_\_\_\_\_. Ju do të merrni një faturë të re, ku tregohet balanca e re e reduktuar.

\_\_\_\_\_ Ju kualifikoheni për zbritje të tarifave në përputhje me normat e ndryshueshme të Nuvance. Ju lutem kontaktoni numrin e telefonit në faturën e re për një plan pagese lidhur me diferencën (nëse është e nevojshme).

\_\_\_\_\_ Kërkesa juaj është refuzuar për arsyen e mëposhtme:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ Tjetër (ju lutem përshkruani me hollësi):

\_\_\_\_\_

Nëse keni pyetje në lidhje me këtë vendim, ju lutem kontaktoni:

\_\_\_\_\_ në  
\_\_\_\_\_, numri i brendshëm \_\_\_\_\_.